

● BREAKING NEWS

NDËRTIMI I SPITALIT RAJONAL NË FIER, KRYEMINISTRI RAMA DEL ME NJOFTIMIN E RËNDËSISË

AKTUALITET

Goditet grupi i grabitësve në Krujë, arrestohen 4 persona nga policia, sekuestrohen armë dhe drogë

SHKRUAR NGA ALBIONA LIPO
20 MARS 2021



Një grup i rrezikshëm grabitësish është goditur dje nga Policia e Krujës, teksa në pranga kanë rënë 4 persona. Bëhet fjalë për të arrestuarit me iniciale D.B., S.S., K.M., A.M., të cilët nga hetimet e kryera deri tani rezultojnë të jenë autorë të vjedhjes me dhunë të një shume të konsiderueshme parash në një karburant në fshatin Arrameras. Banda e grabitjeve, njihen edhe si autorë të vjedhjes së tre motorëve, të cilët i kanë përdorur më pas për të realizuar vjedhje të tjera, kryesisht vjedhje parash në pika karburanti. Sakaq policia ka shpallur në kërkim një bashkëpunëtor të pestë. Ndërsa arrestimi i 4 autorëve u bë paraditen e djeshme në kuadër të operacionit të koduar “Arrameras”. Tashmë të arrestuarit pritet të përballen me akuzën për veprat penale "Vjedhja me dhunë", "Vjedhja" dhe "Kultivimi i bimëve narkotike". “Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë, në bashkëpunim me strukturat hetimore të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, në vijim të punës për zbardhjen e vjedhjeve të ndodhura më parë, si dhe për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e kultivimit të bimëve narkotike, bazuar në provat e grumbulluara gjatë punës hetimore, organizuan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar "Arrameras", në kuadër të të cilit u kapën dhe u arrestuan shtetasit: D. B., 21 vjeç, banues në Magazazë, Fushë Krujë, i dënuar më parë për veprën penale "Vjedhja"; S. S., 17 vjeç, banues në Kamas, Fushë Krujë; K. M., 21 vjeç dhe A. M., 23 vjeç, banues në Thumanë”, thuhet në njoftimin për shtyp nga policia. Thëksojmë se operacioni do të finalizohet, në momentin që do të bëhet arrestimi i 26-vjeçarit H. X., banues në Larushk, tashmë i shpallur në kërkim si bashkëpunëtor dhe i dënuar më parë për veprat penale "Vjedhja" dhe "Armëmbajtje pa leje”. Sekuestrohen drogë, armë e sende të tjera

Gjithashtu, gjatë këtij operacioni policia jep detaje se janë goditur edhe dy raste të tentativës për kultivim të kanabisit nga të arrestuarit. Kështu gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e dy kushërinjve K. M., dhe A. M., janë gjetur rreth 1000 kubikë të kultivuar me fara kanabisi, të cilat janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale. Po ashtu policia ka sekuestruar edhe veshje të përdorura nga autorët për të kryer vjedhjet, 1 automjet tip "Fiat", 2 motorë, 1 armë gjahu teke dhe 1 armë gjahu shotgan, 3 aparate celular dhe sende të tjera të jashtëligjshme. Ndërkohë, nën drejtimin e Prokurorisë po vijon puna për zbardhjen e plotë të veprimtarisë kriminale të këtyre personave, si dhe identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Si dhe materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Vjedhja me dhunë", "Vjedhja" dhe "Kultivimi i bimëve narkotike". Kujtojmë që dy ditë më parë një tjetër grabitje ka ndodhur në zonën e Laprakës, në Tiranë. Mësohet se është grabitur një depo farmaceutike nga presona ende të paidentifikuar. Gjithashtu mësohet se autorët kanë thyer derën e depos dhe kanë vjedhur medikamente me vlerë 1.8 milionë lekë. Në fokus të hajdutëve mësohet se kanë qenë vitaminat, kryesisht vitamina C. Lidhur me këtë ngjarje, Policia është njoftuar nga pronari për ngjarjen dhe po punon për identifikimin e autoreve. Ndërkohë, janë sekuestruar kamerat e sigurisë dhe gjithë provat materiale të lëna nga autorët e dyshuar të ngjarjes.

Më të lexuarat

'Mos qesh o Gonxhe', përfaqësuesi i PS përplasat me gazetarin: Për t'i gjetur faj Ramës, do të më fusësh në sherr me gruan!

“Koronavirusi po bën kërdinë”, Brataj nxjerr të dhënat dhe ngre shqetësimin e madh: Ja çfarë po ndodh jashtë Tiranës

Plas keq në emision/ Koordinatori i PD-Bratajt: S'merr vesh nga këto punë. Kreu i Urgjencës: Injorancën tënde mos ma shit mua!

Partitë politike ndezin nesër zyrtarisht motorët e fushatës elektorale, zbardhen detaje nga organizimi i PS-së, ja çfarë pritet të ndodhë në orën 17:00 në Sheshin Skënderbej

Dilema për vaksinën ruse dhe atë kineze, mjeku shqiptar në Londër tregon cila nga dozat është më e mira: Shqipëria nuk ka luksin për të ...

Diskutimet mbi autorësinë e librit që publikoi Basha, Arjan Çani bën deklaratën e papritur: Jam i bindur që edhe Rama nuk...

Zbardhen detaje nga zjarri në magazinën e qendrës tregtare në Tiranë, dyshohet se roja...

A do të ndahet vaksinimi në grup-mosha për dozat 'Pfizer', 'AstraZeneca' dhe 'Sputnik'? Zv.ministria Eugena Tomini zbulon si do veprohet

E rëndë në Itali! 30-vjeçarja shqiptare humb jetën tragjikisht në aksident, lë pas një vajzë të vogël (Emri+FOTO)

“Fitimtarët”, Artan Hoxha del me mesazhin e FUQISHËM (Foto)

‘Uroj të mos ndodhë, por do ta fusë vendin në shina të reja’, Arian Çani jep parashikimin e frikshëm 30 ditë para zgjedhjeve

Zjarr i madh në Tiranë/ Çfarë ka ndodhur?

Mesazhe Promocionale

Gossip



“Do ja hajmë zemrën njëri tjetrit apo jo?”, Antonela zhvesh Blerimin në takim

Në puntatën e sotme të "Përputhen" po transmetohet takimi ...

Opinione

RAMAZAN SHERJA

Populli nuk ecën kundër vetvetes, por drejt rea...

STILJAN DEDJA

Edhe z.Sali Berisha duhet të jetë subjekt i dek...

GJON BRUÇI

Duke njohur Sevo Tarifën, dëshpërohem për të bi...

ARDI STEFA

Detyra e kujtesës, kujtesa si detyrë!

LEXO OPINIONE TE TJERA